

RASTI SFIDUES, EKONOMIKU MË I INTERESUARI

WUS-Austria, Zyra në Prishtinë, ftoi të enjten studentët kosovarë që të aplikojnë për programin "Kosova Case Challenge 2008" (Rasti sfidues i Kosovës 2008), me ç'rast studentët fitues të kësaj gare do të mundë të marrin pjesë në finalen e madhe "Balkan Case Challenge", që do të mbahet me 6-11 korrik në Vjenë. But Dedaj, drejtor i WUS-Austria, Zyrës në Prishtinë, tha se programi "Kosova Case Challenge 2008" është një sfidë për studentët kosovarë që dijen e tyre teorike ta zbatojnë edhe në praktikë. Ai tha se "Rasti sfidues i Kosovës" synon në hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja studentëve të shkëlqyer të edukimit të lartë të Kosovës, duke i forcuar lidhjet në mes edukimit të lartë dhe punësimit, si dhe ofrimin e shanseve konkrete për punë. Duke shpjeguar programin e projektit, ai tha se gara studimore, e bazuar në metodën e rastit studimor, zhvillohet në katër disiplina: rasti biznesit, që përfshin studentët e të gjitha fushave të ekonomikut; teknologjia informa-



tive dhe komunikuese, që përfshin studentët e shkencave teknike; modeli i Këshillit të Evropës, që përfshin studentët e shkencave politike, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, sociologji etj dhe rasti i katërt është simullmi i gjyqit, e që do të përfshijë studentët e juridikut. Dedaj, shpjegoi se kësaj here ky program ka disa objektiva: kompanive të ndryshme t'u ofrojë studentë të shkëlqyer në mënyrë që t'i punësojë

ata si kuadër, pastaj kompanitë problemet e ndryshme të tyre të mund t'i zgjidhin nga studentët të cilët konkurrojnë, mundësia që kompanitë të ofrojnë bursa për studentë, krijimi i rrjetit të komunikimit në regjion etj. Kësaj radhe, gara "Kosova Case Challenge 2008" do të përbëhet nga tri pjesë: trajnimi për aplikues lidhur me garën e rastit studimor, gara ku fituesit nga çdo disiplinë do të selektohen për garën "Balkan Case

Challenge", që do të mbahet në Vjenë dhe ngjarja e rekrutimit. Koordinatorja e projektit, Mjellma Carabregu, tha se interesimi më i madh për këtë garë është i studentëve të ekonomikut, ndërsa afati i konkurrimit ka filluar që nga 18 janari dhe do të vazhdojë deri më 31 mars, ndërsa gara në Kosovë do të mbahet gjatë periudhës 10-11 maj, ku fituesit do të kualifikohen direkt për finalen ndërkombëtare që do të mbahet me 6-11 korrik 2008, në Vjenë. "Kosova Case Challenge 2008", organizohet për herë të katërt, ndërsa nga 50 studentët që do të jenë në listën e ngushtë, 8-10 prej tyre do të arrijnë të marrin pjesë në garën e Vjenës. Këtë vit "Balkan Case Challenge, prezanton gjysmëfinalen në 11 vende të Evropës Juglindore, duke e vazhduar traditën e saj në Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbi, ndërsa është duke u organizuar për herë të parë në Maqedoni, Mal të Zi, Moldavi, Bullgari, Kroaci, Rumani, Slloveni, si dhe në Austri.

B. SALIHU